

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA " B & A-'02 " SH.P.K

Une Leni GRUDA, e bija e Vasilit dhe e Venes, e lindur me 24.06.1974 ne Vernik, Devoll dhe banuese ne Tirane, Rruga " Sadiq Petrela" Nr.2, vendosa te perpiloj kete STATUT te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "B & A-'02" sh.p.k, oratk i vetem si me poshte vijon:

### KREU I PARE

### EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, KAPITALI, OBJEKTI

#### NENI 1

Shoqeria emertohet " B & A-'02 " sh.p.k

#### NENI 2

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "B & A-'02 " sh.p.k do te jete ne qytetin e Tiranes, rruga " Sadik Petrela" nr.2

#### NENI 3

Kohezgjatja e Shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregetar prna Gjykates se Rrethit Tirane.

#### NENI 4

Kapitali themelor i Shoqerise do te jete 100.000 leke, prone e ortakut te vetem. Kapitali themelor i Shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut te vetem themelues te Shoqerise.

#### NENI 5

#### **OBJEKTI** i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

**TREGTIM** me shumice e pakice te mallrave te ndryshem ushqimore dhe industriale Metale celiku,hekuri,bronci,bakrri,alumini; e lende te pare, shufra,profile e prodhime metalike gjithellojesh

Tubo e gypa metelik dhe plastik te llojeve te ndryshme

Kabillo elektrik dhe telefonik gjithellojesh;

Pllaka e paisje hidro-termosanitare.elektroda e tela gjithellojesh

Artikuj kancilerie

Makineri,mjete transporti,pjese kembimi; vajra lubrifikante me pakice

Paisje elektrike,elektroteknike,elektronike,elektroshtepijake dhje pjese kembimi per to

#### **PRODHIM** dhe tregtim:

Dyer-dritare e grila duralumini, plastike e metalike;

Materiale inerte e ndertimi,

Konfeksione dhe kepuce gjithellojesh.

#### **SHERBIME:**

Servis automjetesh , paisjesh elektronike dhe elektroshtepijake

Bar -Restorante-Hoteleri

Spedicion mallrash dhe transport udhetares

#### **IMPORT- EXPORT**



## **KREU I DYTE**

### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 6**

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i Shoqerise.

#### **NENI 7**

Ortaku i vetem ka te drejta dhe detyrime:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, inventareve dhe i bilancit te llogarise vjetore.
3. Zgjidhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave e i kompetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe caktohen ne Statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i cmimeve per mallerat qe trajton shoqeria dhe i tarifave te sherbimit.
6. Pranimi ne pune dhe largimi nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te Shoqerise.
8. Kryerja e the gjithe veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer per llogari dhe interes te saj.

#### **NENI 8**

Administratori jo ortak pervec detyrave qe i cakton ortaku i vetem ka edhe keto detyra:

- Te mireadministroje pasurine e shoqerise.
- Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se Shoqerise dhe kompetencave te caktuat nga ortaku i vetem.
- Te zbatoje rregulloren e brendeshme te Shoqerise.
- Te perqigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
- Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me Ortakun e vetem.
- Te marre te dhena e te beje propozime per gjithshka qe e cmon si te dobishme per shoqerine.

## **KREU I TRETE**

#### **NENI 9**

Shoqeria ka te drejte:

1. Te importoje dhe te eksportoje mallra ne bzae te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke e valute nga bankat vendase e te huaja ne baze te regullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqipetar lidhur me tatimet e te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte e te kualifikuar vendas dhe te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "F. Vlora".

## **NENI 10**

SHOQERIA ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne forme e ne kohen e duhur.
2. Te jape garanci per mallerat qe trajton dhe sherbimet qe kryen.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale e sociale qe ka ndaj shtetit si dhe detyrime kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet shteterore dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

## **KREU I KATERT**

### **MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE**

#### **NENI 11**

E gjithe veprimtaria e Shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

#### **NENI 12**

Ne seline e Shoqerise mbahet dokumentacioni finanziar ne baze te te cilit brenda 31 Mars te cdo viti nxirret bilanci.

#### **NENI 13**

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

#### **NENI 14**

Shoqeria mban xhiro llogarite ne Banken Kombetare Tregetare Shqipetare. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkates.

#### **NENI 15**

Nga fitimet e realizuara gjate vitit finanziar Shoqeria pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijon findin "rezerve e domosdoshme" deri sa ky te arrije ne masen 10% te kapitalit themeltar.

#### **NENI 16.**

Ortakut te vetem i takon fitimi neto qe realizon Shoqeria.

## **KREU I PESTE**


### **DISPOZITA TE VECANTA.**

#### **NENI 17**

Shoqeria ka vulen e vete dalluese.

#### **NENI 18**

Per plotesimin e nevojave te veta Shoqeria mund te punesoje punetore te thjeshte e te kualifikuar, vnedas ose te huaj. Me secilin punonjes lidhet kontrate individuale e punes dhe kur eshte rasti me kontrate kolektive te punes, ne kontrate shenohen te drejtat dhe detyrimet reciproke. Per personat qe do te merren ne pune me detyra te vecanta lidhen kontrata individuale.



### **NENI 19**

Ne seline e Shoqerise mbahet nje register i posacem ne te cilin pasqyrohen vendimet qe merren nga ortaku i vetem e administratore jo-ortake.

### **NENI 20**

Ne maredhenie me te tretet Shoqeria "B & A-'02" sh.p.k perfaqesohet nga Administratori i saj, znj Leni GRUDA cili ne rast te vecante mune te autorizoje persona te tjere per ta perfaqesuar.

### **NENI 21**

Mosmarreveshjet qe mund t'i lindin Shoqerise me persona fizik Juridik, vendas e te huaj zgjidhen nga gjykatat shqipetare, pervec rasteve kur ne kontrate eshte parashikuar ndryshe.

## **KREU I GJASHTE**

### **SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

### **NENI 22**

Shnderrimi i Shoqerise "B & A-'02" sh.p.k ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtit te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut te vetem.

### **NENI 23**

Shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe e nga cdo shkak si:

- Humbja e kapitalit te Shoqerise; pamundesa e veprimit; me ventdim te ortakut te vetem. Ne keto raste proneri i shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit dhe caktton nje ose me shume likujdatore duke iu caktuar dhe detyrat. Administratori e likujdatori jane perjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise deri sa ajo t'i dorezohet personave perkates fizik apo juridik, duke likujduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast se fondet disponibel rezultojne te mjaftueshme per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likujdatori mund t'i kerkonte ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe i takojne atije respektivisht.

## **DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

### **NENI 24**

Persa nuk shprehet plotesishte ne kete Statut, plotesimet behen nga oratku themelues sipas legjislacionit shqipetar ne fuqi. Ndryshimet dhe plotesimet e ketije Statuti behen ne menyren procedurjale me te cilen nxirret vet Statuti.

### **NENI 25**

Ky Statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise private "B & A-'02" sh.p.k.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
"B & A-'02" SH.P.K  
Leni GRUDA**

